



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

Komuna e Dragashit / Komisioni i themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Dragashit, 01nr.060/01-2095-12/24 të datës 31.01.2024, në bazë të neneve 4, 5, 6, 8.1.1 dhe nenit 15 të Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, dhe bazuar në nenet 4, 5, 8, 9 dhe 10 të Rregullores së VRK-së nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, në pajtim me Vendimin Preliminar të Kuvendit të Komunës për shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtshme komunale, 01 nr.060/01-2095-11/24 të datës 31.01.2024, më 25.03.2024, publikon:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

Për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të përkohshëm.

Lënda e ankandit publik:

- **Pronë e paluajtshme komunale / Parkingu në Dragash, në ngastrën kadastrale P-70604014-00782-0 ZK Dragash, afër Gjykatës në Dragash;**
- **Sipërfaqja e parkingut:** 1700 m²;
- **Qëllimi i veprimtarisë:** menaxhimi i parkingut;
- **Afati i shfrytëzimit:** 4 (katër) vjet nga dita e nënshkrimit të Kontratës për dhënien në shfrytëzim...
- **Qmimi fillestar - oferta:** 250 € (dyqind e pesëdhjet euro) në muaj.

KRITERET, AFATET, PROCEDURAT DHE KUSHTET

- Kriteri fitues i ankandit - **çmimi më i lartë i ofruar;**
- Afati për dorëzimin e ofertave: **brenda 15 ditëve nga shpallja e ankandit publik, në webfaqen e Komunës, gjegjësisht në mediat publike, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Dragashit, pra nga 25.03.2024 dhe zgjat deri në 09.04.2024 si afat i fundit i parashtrimit të ofertave.**
- Përparësi kanë përdoruesit e deri tanishëm që kanë vepruar në përputhje me detyrimet sipas kontratës.
- Përmbajtja e ofertës: **Shënimi i hapësirës për të cilin personi juridik apo fizik është i interesuar, siç është përshkruar më sipër, çmimi i përcaktuar qartë, aktiviteti që do të kryhet, numri i telefonit kontaktues dhe adresa e ofertuesit** - Ofertat për ankand publik mund ti paraqesin të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Nëse bëhet fjalë për kompani/biznes apo ndërmarrje, kërkohet licencë.
- **Dorëzimi i ofertave:** Ofertat në zarfe të mbyllura do të dorëzohen përmes Zyrës së Pranimiit drejtuar Komisionit Vlerësues për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale të Dragashit. Ofertat dorëzohen në zyrën e pranimiit dhe dorëzohen me një tarifë prej 15,00 €. Ofertës duhet ti bashkangjitet edhe një dëshmi të lëshuar nga Drejtoria e Financave se ofertuesi nuk ka borxhe ndaj Komunës së Dragashit.
- **Hapja e ofertave / Ankandi Publik do të bëhet më 15.04.2024 në sallën e Kuvendit Komunal në ora 11.00.** Nëse lind nevoja mund të ndryshohet vendi i mbajtjes së Ankandit.
- Formularët e ofertës mund të merren në shërbimin e pranimiit të Komunës së Dragashit.



PËRKUFIZIMET

Ofertat të cilat nuk do të konsiderohen apo pranohen, pavarësisht nga çmimi i ofruar:

1. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve financiare ndaj Komunës që rrjedhin nga Marrëveshjet e lidhura më parë në lidhje me shfrytëzimin e Pasurive të Paluajtshme Komunale, në atë rast nuk do të pranohen ofertat e bëra nga as edhe nga anëtarët e familjes si bashkëshorti, djemtë, vajzat dhe bashkëshortët e tyre, pra do të refuzohen me konstatim se ekzistojnë përkufizimet;
2. Në rast se pjesëmarrësi në Ankandin Publik nuk e ka dorëzuar dëshminë e lëshuar nga Drejtoria e Financave se ofertuesi nuk ka borxhe ndaj Komunës së Dragashit, në bazë të tatimit ose obligimeve tjera.
3. Në rast se ju referohet aktiviteteve që janë të ndaluara me ligj, pra përdorimi për qëllime të ndaluara.

TË DREJTAT E PJESËMARRËSVE NË ANKAND DHE TËRHEQJA NGA OFERTA

- Personi fizik apo juridik i interesuar për ofertuar ka të drejtë të informohet për procedurën e ankandit publik, të ketë qasje në dokumentacionin kadastral dhe pronësor në lidhje me hapësirën dhe qasje fizike për ta shikuar.

Secili ofertues mund të tërhiqet nga ankandi publik ose të tërhiqet nga oferta jo më vonë se 3 ditë para hapjes së ofertave - mbajtjesë së ankandit publik. Tërheqja bëhet me shkrim dhe dorëzohet në Zyren e pranimit e Komunës së Dragashit. Mosparaqitja në hapjen e ofertave nuk do të konsiderohet tërheqje nga ankandi publik.


Ky njoftim do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Dragashit në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e lartpërmendur; në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe të paktën një nga mediat elektronike.

Kontakt tel. 044 390 825

Dragash;

Dt. 18.03. 2024

Anëtar i Komisionit:
Isljam Redzeplari



Kryetar i Komunës



Dr. Bexhet Meladini

